



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 2 shkurt 2015

Numri i lëndës: 2014-29

Shemsi Musa

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 2 shkurt 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 22 prill 2014.

II. FAKTET

2. Nga shtatori 2001 deri në qershor 2002, ankuesi ia kishte lëshuar banesën e tij me qira në Prishtinë dy policëve ndërkombëtarë që

punonin në UNMIK. Më vonë ai kishte gjetur se ata ishin larguar nga banesa pa e paguar faturën e tyre të telefonit, që arrinte shumën prej 2.176,50 eurosh (dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë euro e pesëdhjetë cent).

3. Më 13 qershor 2003, kompania e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK) kishte parashtruar padi kundër ankuesit pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke kërkuar pagesën e faturës së papaguar të telefonit.
4. Më 22 dhjetor 2008, Gjykata Komunale ka hedhur poshtë atë padi. PTK-ja kishte apeluar kundër këtij aktgjykimi më 17 mars 2009.
5. Më 7 mars 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, në përbërje të trupit gjykues prej tre gjykatësve të Kosovës, kishte miratuar ankesën, e kishte ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe kishte urdhëruar që ankuesi të paguante faturën e kontestuar.

III. ANKESAT

6. Ankuesi pohon se janë shkelur të drejtat e tij ekonomike, pa përmendur ndonjë dispozitë të veçantë të dokumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

IV. LIGJI

7. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
9. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.

10. Paneli konstaton se nuk është argumentuar, e lëre më dëshmuar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesit.
11. Si pasojë, çështjet që janë ngritur nga ankuesi nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Si rrjedhojë, ato bien jashtë kompetencës së Panelit, siç saktësohet në rregullin 25 të rregullores së vetë të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (krahasoni *Shqip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013 § 9; *Jovanka, Dragan and Milan Vukovic kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, §§ 11-12).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi bie jashtë të tij në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese